



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 932/11 Prot.
Datë: 16.06.2020

Nr. ___ Prot

Vlorë, më 11/06/2020

VENDIM

Nr. 8....., datë 11.06.2020

**PËR PLANIN E MASAVE PËR PËRMIRËSIMIN E VAZHDUESHËM TË CILËSISË
NË PROGRAMET E STUDIMIT DHE MËSIMDHËNIEN NË UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 40 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Senatit Akademik Nr. 21, datë 08.05.2019, referuar rezultateve të Pyetësorëve të Studentëve për Vlerësimin e Cilësisë së Mësimdhënieve për vitin akademik 2018-2019 për lëndët e çdo programi studimi si dhe propozimeve të Njësiave Kryesore, Rektorati në mbledhjen e datës 11.06.2020

VENDOSI:

1. Të miratoj për çdo Njësi Bazë sipas shtojcave bashkëlidhur planin e masave respektiv për programet e studimit që ofron.
2. Ngarkohet çdo Njësi Bazë të përfshijë në raportin vjetor të punës verpimtaritë konkrete të ndërmarra në kuadër të përmbushjes së planit të masave.
3. Ngarkohet Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional të monitorojë zbatimin e planit të masave për çdo njësi bazë dhe të raportojë pranë Senatit Akademik mbi ecurinë e përmbushjes së planit të masave të miratuar në këtë Vendim Senati.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zv/ Rektorët, Administratori, Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr. Roland Zisi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Shtojca 1:

Plani i Masave për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Cilësisë në Programeve të Studimit dhe Mësimdhënien në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë në Fakultetin e Ekonomisë.

A. Departamenti i Ekonomiks:

- Përfshirjen në orën e mësimit të rasteve të studimit përmes analizimit të punimeve shkencore me fokus Shqipërinë duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik deri në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo situatë të analizuar.
- Përfshirjen në debat të studentëve me njëri –tjetrin, me qëllim nxitjen e të punuarit në grup pune në situatë të konkurrencës së tyre me grupet e tjera të punës, debate në të cilat fokusi të jenë problematikat ekonomike shqiptare, por jo vetëm, por gjithnjë në përputhje me temën e mësimit që shpjegohet nga pedagogu.
- Seminarët të zhvillohen duke aplikuar më shumë "case study";

B. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit:

- Përfshirjen në orën e mësimit të rasteve të studimit përmes analizimit të punimeve shkencore me fokus Shqipërinë duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik deri në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo situatë të analizuar.
- Përfshirjen në debat të studentëve me njëri –tjetrin, me qëllim nxitjen e të punuarit në grup pune në situatë të konkurrencës së tyre me grupet e tjera të punës, debate në të cilat fokusi të jenë problematikat ekonomike shqiptare, por jo vetëm, por gjithnjë në përputhje me temën e mësimit të që shpjegohet nga pedagogu.
- Seminarët të zhvillohen duke aplikuar më shumë "case study";
- Vënie në funksion të Laboratorit;
- Biblioteka on-line të vihet në funksion për studentët dhe pedagogët;
- Duhet të inkurajomë kërkimin shkencor të studentët që mund të aktivizohen edhe jashtë teksteve mësimore.

C. Departamenti i Biznesit:

- Përdorimi i literaturës që i përket autorëve më të mirë të asaj fushe por edhe botimeve më të fundit;
- Përdorimi i teknikave bashkëkohore në mësimdhënie, dhe zhvillimit të mësimit në mënyrë interaktive.
- Konkretizimi i teorisë përmes shembujve praktikë të marrë nga realiteti shqiptar dhe i huaj.
- Përfshirja e studentëve në analizimin e punimeve shkencore të autorëve vendas apo të huaj duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik përmes dhënies së konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo situatë të analizuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

- Përfshirja e sa më shumë rasteve të studimit gjatë orëve të seminareve të ofruara për t'u punuar nga pedagogu apo të zgjedhura nga vetë studentët.
- Përmirësimi i kushteve për studentët në auditorët ku ata zhvillojnë mësim përmes identifikimit të nevojave dhe përcjelljes së kërkesave buxhetore në nivel njësie bazë dhe kryesore.



Shtojca 2

Plani i Masave për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Cilësisë në Programeve të Studimit dhe Mësimdhënien në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë në Fakultetin e Shëndetit Publik.

A. Departamenti i Infermierisë :

- Të rishikohet literatura për lëndët respektive, në mënyrë që të gjejmë literaturë bazë më të kuptueshme nga ana e studentëve;
- Të vazhdohet me modelin e mësimdhënies të nisur pas analizës së pyetësorit të vitit të kaluar me studentin në qendër mbasi kemi konstatuar se ky model është më efektiv për tërheqjen e studentit në pjesëmarrjen në mësim;
- Të përmirësojmë teknologjinë e mësimdhënies duke përdorur metoda bashkëkohore për të rritur pjesëmarrjen dhe motivimin e studentëve. Për këtë kemi nisur dhe do të thellojmë përpjekjet për pajisjen e të gjitha sallave të leksioneve me teknologji bashkëkohore qoftë nëpërmjet parashikimit në buxhetin e vitit të ardhshëm, qoftë nëpërmjet aplikimit në projekte të ndryshme;
- Të gjejmë mekanizma për trajnimin e stafit në përdorimin e metodave inovative dhe përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies.
- Të simulojmë situata të ngjashme në jetën reale në laboratore me qëllim aftësimin e studentëve në gjetjen e zgjidhjeve evidence-based.
- Të shtojmë numrin e orëve të konsultimeve dhe të organizojmë studentët në grupe të vogla konsultimi për secilën lëndë të programit, me qëllim kapërcimin e pengesave të hasura gjatë studimit të literaturës.

B. Qendra kërkimore Shkencore:

- Përdorimi i metodave interaktive të mësimdhënies duke integruar në orën e mësimi metodën klasike të mësimdhënies, së bashku me metodat interaktive (prezantime me poëerpoint, video-animacione, simulime)
- U sugjerua që të rishikohet literatura dhe redaktimi i saj në mënyrë që të jetë sa më e qartë dhe e kuptueshme për studentët; po ashtu në fund të orës së leksionit të lihet një hapsirë kohore për pyetjet nga ana e studentëve lidhur me paqartësinë e tematikës së leksionit;
- Sugjerojmë adaptimin e teknikave të mësimdhënies me studentin në qendër, ku si pedagogu edhe studentët të luajnë një rol të caktuar në procesin e të mësuarit. Këto teknika do bëjnë që studentët të jenë pjesëmarrës aktiv dhe të ndërtojnë njohuri përmes bashkëveprimit, angazhimit dhe ndarjes së njohurive.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

- Nisur nga rezultatet e pyetësorëve sugjerojmë që pedagogët të rishikojnë syllabuset përkatëse dhe të marrin në konsideratë përfshirjen e informacioneve shtesë në leksione, veç atyre që parashikon literatura e detyruar.

C. Departamenti i Kujdesit Shëndetësor:

- Identifikimi i problemeve specifike dhe konkrete lidhur me vështirësitë e hasura gjatë studimit të literaturës.
- Kalimi nga modeli i të mësuarit me "prezantim faktesh" (pedagogu në qendër) në modelin " student në qendër". Mësimi dhe mësimdhënia me studentin në qendër luan një rol të rëndësishëm në stimulimin e motivimin, vetë-reflektimin, të menduarin ekonomik, të menduarin kritik dhe angazhimin e studentëve në procesin e të mësuarit.
- Përdorimi i qasjeve më efektive pedagogjike të cilat lehtësojnë procesin e të mësuarit tek studentët. Ështëi nevojshëm adaptimi i disa teknikave apo përdorimii disa instrumentave të cilat do të lehtësonin procesin e mësimnxënies. Për ta familjarizuar stafin akademik me këto teknika janë parashikuar strategji si:
 - Parashikimi në buxhet i një granti specifik për përmirësimin e mësimdhënies nëpërmjet trajnimeve brenda dhe jashtë vendit.
 - Aktiviteteve trajnuese për stafin akademik mbi teknikat e reja pedagogjike, teroritë e mësimnxënies, përparimet teknologjike dhe format moderne të vlerësimit etj. Nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte/ trajnime të ndryshme të BE-së, organizmit të trajnimeve të ndryshme në bashkëpunim me Universitete të tjera Shqiptare dhe të huaja, organizimi i kurseve verore dhe konferencave, pjesëmarrjes në aktivitete të organizuara mbi tematikë si psh: MASR, Universitete të tjera, Organizata etj.
 - Hartimi dhe shqyrtimi i strategjive pedagogjike në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit.
 - Përfshirja në Mësimdhënie e pedagogëve si ekspertë më të mirë të fushës, shqiptarë dhe të huaj nga Universitete më të mira europiane me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe huazimin e metodikave bashkëkohore dhe produktive në fushën e mësimdhënies.
 - Plotësimi i auditorëve/ laboratorëve me logjistikë bashkëkohore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Shtojca 3:

Plani i Masave për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Cilësisë në Programeve të Studimit dhe Mësimdhënien në Universitetin " Ismail Qemali", Vlorë në Fakultetin e Shkencave Humane :

A. Departamenti Edukimit:

- Shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve për të shfrytëzuar 100% orën e mësimin nga ana e pedagogëve.
- Rritjen e nivelit të komunikimit pedagog student brenda orës së mësimin;
- Arritjen maksimale të dakortësimin për vlerësimin e studentëve.
- Të eliminohet presioni mbi studentët për notën.

B. Departamenti I Gjuhë Shqipe dhe Letërsisë:

- Shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve për të shfrytëzuar 100% orën e mësimin nga ana e pedagogëve, përdorimi i literaturës që u përket autorëve të asaj fushe por edhe botimeve të fundit;
- Përdorimi i teknikave bashkëkohore në mësimdhënie dhe zhvillimi i mësimin në mënyrë interaktive;
- Përfshirja e studentëve në analizimin e punimeve Shkencore, duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik përmes dhënies së konkluzioneve dhe rekomandimeve për situatat e analizuara.
- Rritjen e nivelit të komunikimit pedagog- student brenda orës së mësimin;
- Arritjen maksimale të dakortësimin për vlerësimin e studentëve.
- Të eliminohet presioni mbi studentët për notën.
- Përmirësimi i kushteve për studentët në auditorët ku ata zhvillojnë mësimin përmes identifikimit të nevojave dhe përcjelljes së kërkesave buxhetore në nivel Njësie bazë dhe kryesore.

C. Departamenti I Gjuhëve të Huaja:

- Aplikimi i disa teknikave apo përdorimi i disa instrumentave më efikase prej pedagogëve respektivë, të cilat do të lehtësonin procesin e mësimnxënies si përdorimi i materialeve audio- video;
- Rishikimi i teknikave të mësimdhënies të orientuara me studentin në qendër, ku si pedagogu ashtu edhe studentët tanë të jenë pjesëmarrës aktivë dhe të ndërtojnë njohuri përmes bashkëveprimit, angazhimit dhe ndarjes së njohurive mes njëri- tjetrit.
- Përmirësimi i formatit të pyetësorit për pedagogët me pyetje më të qarta.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

- Bërja e detyrueshme e pyetësorit jo vetëm për pedagogët, por edhe për sekretarët mësimore. Kjo do të evidentonte problematikat e mundshme dhe do të çonte në përmirësimin e performancës së tyre.

D. Departamenti i Drejtësisë:

- Sigurimin e një mekanizmi të përshtatshëm për pjesëmarrjen e plotë të të gjithë studentëve në pyetësor;
- Pyetësori të mund të plotësohet nga studentët përpara hyrjes në provim dhe menjëherë pas përfundimit të leksioneve;
- Krijimin e disa kushteve shtesë në infrastrukturën mësimore që do të ndihmonin në rritjen e performancës së mësimdhënies dhe të interesit të studentëve në lidhje me procesin mësimor, midis të cilave propozohet pajisja e të gjitha klasave të Departamentit me dërrasa elektronike, ose të paktën të bardha, si dhe projektor të instaluar në mënyrë të përhershme.
- Gjithashtu kërkohet që UV të krijojë kushtet për të bërë të mundur që çdo pedagog të mund të flonte – me shpenzimet e UV – të paktën një herë në çdo semestër, një pedagog të jashtëm apo të huaj për leksione të hapura. Ky do të ishte një hap tejte i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies dhe marrjes së ekspriencës më të mirë.
- Vënien në funksion të plotë të bibliotekës digjitale si një hap shumë konkret për arritjen e rezultateve të kërkuara dhe objektivave të mësimdhënies.
- Përmirësimi dhe rritja e standardeve të kërkimit shkencor nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca dhe kongrese shkencore;
- Përditësimi i vazhdueshëm i kurrikulave dhe programeve studimore sipas modeleve më të mira bashkëkohore;
- Përditësimi i literaturës mësimore me tekstet dhe manualët akademike sipas standardeve universitare të Bashkimit evropian;
- Rritja e aftësisë praktik të studentëve diplomantë nëpërmjet riorganizimit të plotë të marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave profesionale pranë subjekteve të interesuara;
- Rritja dhe forcimi i rolit të Klinikës së Ligjit, të krijuar pranë Departamentit të Drejtësisë, në ofrimin e shërbimeve ligjore falas ndaj shtresave në nevojë, përfituese të shërbimit ligjor falas;
- Forcimi dhe shtimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me mobilitetet studentore dhe të stafit akademik me departamentet bashkëpunuese të rrjeteve të ndryshme universitare ndërkombëtare;
- Ndërgjegjësimi i stafit akademik dhe ndihmës-akademik për vendosjen e studentit në qendër të vëmendjes dhe interesave të UV-së duke koordinuar përpjekjet dhe strategjitë e Departamentit me ato të Institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Shtojca 4:


Plani i Masave për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Cilësisë në Programeve të Studimit dhe Mësimdhënien Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë në Fakultetin e Shkencave Teknike :

A. Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.

- Thjeshtëzimi i përmbajtjes së çështjeve të trajtuara në leksione dhe seminare, brenda një kornize të lejueshme e gjykuar kjo nga vetë pedagogu. Njëkohësisht konkretizimi i njohurive teorike sa më shumë në seminare dhe ushtrime.
- Përdorimi i metodave të reja të mësimdhënies, ku në qendër të orës së mësimit është studenti. Gjithashtu të stimulohet debati dhe mendimi kritik, duke realizuar një orë mësimore me interes për studentin.
- Në të gjitha rastet, kur është i mundur të kryhet trajtim demonstrativ i fenomeneve apo dukurive të ndryshme fizike në nivel të lartë.
- Një punë më e madhe duhet të bëhet nga ana jonë lidhur me sensibilizimin e studentëve për pjesëmarrje të lartë në anketimet e kryera në përgjithësi e sidomos për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të programeve të studimit.
- Një punë më e madhe do bërë nga ana jonë që të sigurohet një pjesëmarrje më e lartë e studentëve në konsultimet e bëra nga pedagogët. Nëse është nevojshme do të shtohen oraret e konsultimeve.

B. Departamenti i Matematikës:

- Përdorimi i literaturës që i përket autorëve më të mirë të asaj fushepor edhe botimeve më të fundit.
- Përdorimi i teknikave bashkëkohore në mësimdhënie, dhe zhvillimi i mësimin në mënyrë interaktive.
- Konkretizimi i teorisë përmes shembujve praktikë.
- Përfshirjen e studentëve në analizimin punimeve shkencore të autorëve vendas apo të huaj duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik përmes dhënies së konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo situatë të analizuar.
- Përfshirja e sa më shumë rasteve të studimit gjatë orëve të semiareve të ofruara për tu punuar nga pedagogu apo të zgjidhura nga vetë studenti.
- Përmirësimi i kushteve për studentët në auditore ku ata zhvillojnë mësimin përmes identifikimit të nevojve dhe përcjelljes së kërkesave buxhetore në nivel njësie bazë dhe kryesore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

C. Departamenti i Biologjisë :

- Ngritja e kërkimit shkencor në nivelet bashkëkohore duke i shërbyer procesit të mësimdhënies si dhe ngritja e bazës së të dhënave që i shërbejnë kërkimit shkencor.
- Sigurimi i përvojave arsimore shkencore cilësore për studentët, në mënyrë që të aftësohen për të arritur një zhvillim të plotë intelektual, profesional e shoqëror.
- Të sigurohet një mjedis pozitiv i të nxënit si dhe një proces mësimdhënie rezultativ që evoluon vazhdimisht.
- Stafi të përmirësohet vazhdimisht në funksion të programit, përmes zhvillimit profesional, duke rritur aftësitë e tij mësimdhënëse e shkencore.
- Stafi të përdor mjete e strategji inovative që rrjedhin nga transferimi i teknologjisë për procesin e edukimit dhe kërkimit shkencor.
- Të zhvillohet një kurrikul bashkëkohore në mënyrë motivuese, progresive e stimuluese për të gjithë nivelet e studentëve.
- Studentët të fitojnë një sërë njohurish praktike nëpërmjet përdorimit të laboratorëve si dhe punës me terrenin.
- Studentët të përfitojnë njohuri mbi përpunimin e informacionit, shkrimin akademik dhe aftësitë të prezantimit të dijeve të tyre në publik.
- Studentët të aftësohen dhe të japin gjykimin e tyre për aspektet problematike shkencore mjedisore.
- Përdorimit të literaturës që i përket autorëve më të mirë të asaj fushe por edhe botimeve më të fundit.
- Përmirësimi i kushteve për studentët në auditorët ku ata zhvillojnë mësimin përmes indentifikimit të nevojave dhe përcjelljes së kërkesave buxhetore në nivel njësie bazë dhe kryesore.

D. Departamenti i Kimisë :

- Ngritja e kërkimit shkencor në nivelet bashkëkohore duke i shërbyer procesit të mësimdhënies si dhe ngritja e bazës së të dhënave që i shërbejnë kërkimit shkencor.
- Sigurimi i përvojave arsimore shkencore cilësore për studentët, në mënyrë që të aftësohen për të arritur një zhvillim të plotë intelektual, profesional e shoqëror.
- Të sigurohet një mjedis pozitiv i të nxënit si dhe një proces mësimdhënie rezultativ që evoluon vazhdimisht.
- Stafi të përmirësohet vazhdimisht në funksion të programit, përmes zhvillimit profesional, duke rritur aftësitë e tij mësimdhënëse e shkencore.
- Stafi të përdor mjete e strategji inovative që rrjedhin nga transferimi i teknologjisë për procesin e edukimit dhe të kërkimit shkencor.
- Të zhvillohet një kurrikul bashkëkohore në mënyrë motivuese, progresive e stimuluese për të gjithë nivelet e studentëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

- Studentët të fitojnë një sërë njohurish praktike nëpërmjet përdorimit të laboratorëve si dhe punës me terrenin.
- Studentët të përftojnë njohuri mbi përpunimin e informacionit, shkrimin akademik dhe aftësi të prezantimit të dijeve të tyre në publik.
- Studentët të aftësohen dhe të japin gjykimin e tyre për aspektet të problematikeve shkencore mjedisore.
- Përdorimit të literaturës që i përket autorëve më të mirë të asaj fushe por edhe botimeve më të fundit.
- Përmirësimi i kushteve për studentët në auditorët ku ata zhvillojnë mësimin përmes identifikimit të nevojave dhe përcjelljes së kërkesave buxhetore në nivel njësie bazë dhe kryesore.

E. Departamenti i Shkencave Detare :

- Përdorimit të literaturës që i përket autorëve më të mirë të asaj fushe por edhe botimeve më të fundit.
- Përdorimit të teknikave bashkëkohore në mësimdhënie, dhe zhvillimit të mësimin në mënyrë interaktive.
- Konkretizimi i teorisë përmes shembujve praktikë të marrë nga realiteti Shqiptar dhe i huaj.
- Përfshirjen e studentëve në analizimin punimeve shkencore të autorëve vendas apo të huaj duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik përmes dhënies së konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo situatë të analizuar.
- Përfshirja e sa më shumë rasteve të studimit gjatë orëve të seminareve të ofruara për tu punuar nga pedagogu apo të zgjedhura nga vetë studenti.
- Përmirësimi i kushteve për studentët në auditorët ku ata zhvillojnë mësimin përmes identifikimit të nevojave dhe përcjelljes së kërkesave buxhetore në nivel njësie bazë dhe kryesore.

F. Departamenti i Shkencave Kompjuterike:

- Përdorimit të literaturës që i përket autorëve më të mirë të asaj fushe por edhe botimeve më të fundit.
- Përdorimit të teknikave bashkëkohore në mësimdhënie, dhe zhvillimit të mësimin në mënyrë interaktive.
- Konkretizimi i teorisë përmes shembujve praktikë të marrë nga realiteti Shqiptar dhe i huaj.
- Përfshirjen e studentëve në analizimin punimeve shkencore të autorëve vendas apo të huaj duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik përmes dhënies së konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo situatë të analizuar.
- Përfshirja e sa më shumë rasteve të studimit gjatë orëve të seminareve të ofruara për tu punuar nga pedagogu apo të zgjedhura nga vetë studenti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

- Përmirësimi i kushteve për studentët në auditorët ku ata zhvillojnë mësimin përmes identifikimit të nevojve dhe përcjelljes së kërkesave buxhetore në nivel njësie bazë dhe kryesore.

G. Departamenti i Fizikës:

- Përdorimit të literaturës që i përket autorëve më të mirë të asaj fushe por edhe botimeve më të fundit.
- Përdorimit të teknikave bashkëkohore në mësimdhënie, dhe zhvillimit të mësimin në mënyrë interaktive.
- Konkretizimi i teorisë përmes shembujve praktikë si dhe zhvillimi me një cilësi të lartë të punëve laboratorike në disiplinat e fizikës.
- Përfshirjen e studentëve në analizimin punimeve shkencore të autorëve vendas apo të huaj duke nxitur dialogun dhe stimuluar mendimin kritik përmes dhënies së konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo situatë të analizuar.
- Përfshirja e sa më shumë rasteve të studimit gjatë orëve të semiareve të ofruara për tu punuar nga pedagogu apo të zgjidhura nga vetë studenti.
- Përmirësimi i kushteve për studentët në auditore dhe në sallat e laboratorëve, ku ata zhvillojnë mësimin përmes identifikimit të nevojve dhe përcjelljes së kërkesave buxhetore në nivel njësie bazë dhe kryesore.